



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 4 /2023  
Datë: 10.01.2023

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ, Nr. 7, 01 mars 2019), në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 34, 18 nëntor 2022), dhe duke u bazuar në nenin 368 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118, si dhe në përputhje me nenin 8 paragrafi 1 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK - Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar me Rregulloren QRK-Nr.04/2021 dhe Rregulloren QRK-nr. 03/2022, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z.Illir Mulhaxha, përmbartues privat në Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë **suspendohet nga ushtrimi i funksionit të përmbartuesit privat deri në një vendim të Komisionit Disiplinor.**
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Me datë 06.01.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira ka pranuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat z. Ilir Mulhaxha, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me ekzekutimin e Urdhrit për Transfer me numër P.nr. 001/20 të datës 29.12.2022 nga llogaria e Ndërmarrjes “NewCo Llamkos Steel” L.L.C (në likuidim) në Bankën Qendrore të Kosovës, me pretendimin për shkelje flagrante të dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve juridike përkatëse nga ana e përmbartuesit privat z. Mulhaxha.

Në këtë drejtim, dhe bazuar në të dhënat e kërkesës së parashtruar për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmabruetit privat z. Mulhaxha, dhe si rrjedhojë e kallximit penal të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës (AKP), Prokuroria Speciale më datë 04.01.2023, ka nxjerrë urdhër me të cilin ndalohet tërheqja e mjeteve nga llogaria bankare e përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha.

Më datë 10.01.2023, kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha është proceduar në Komision Disiplinor në pajtim më legjislacionin përkatës në fuqi.

Andaj, me qëllim që procedura disiplinore ndaj përmbaruesit privat z Mulhaxha të zhvillohet e pa penguar u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij vendimi mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

*Vendimi i dërgohet:*

- Përmbaruesit privat z. Ilir Mulhaxha;
- Odës së Përmbaruesve Privat;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Profesione të Lira;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

